



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Qeveria – Vlada – Government

**RREGULLORE (QRK) - NR. 04/2026 PËR FUSHAT E PËRGJEGJËSISË
ADMINISTRATIVE TË MINISTRIVE¹**

¹ Rregullorja (QRK) - Nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, është miratuar në Mbledhjen e 02-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 02/02, të datës 20.02.2026.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) dhe nenit 96 (1 dhe 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafit 4 dhe nenit 8 paragrafit 4 (4.5) të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës,

Duke marrë parasysh Vendimin Nr.10-V-004 e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbledhjes plenare të mbajtur më 11 shkurt 2026, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

RREGULLORE (QRK) NR. 04/2026 PËR FUSHAT E PËRGJEGJËSISË ADMINISTRATIVE TË MINISTRIVE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore përcakton numrin e anëtarëve të Qeverisë dhe të emëruarve të tyre, si dhe fushat e përgjegjësisë administrative të ministrive në Qeverinë e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria).

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitave të kësaj rregulloreje duhet t'u përmbahen: Kryeministri, zëvendëskryeministrat, ministrat, zëvendësministrat, këshilltarët politikë, këshilltarët e jashtëm politikë, nëpunësit e punësuar në kabinete dhe nëpunësit civil në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

KAPITULLI II NUMRI I ANËTARËVE TË QEVERISË DHE FUSHAT E PËRGJEGJËSISË ADMINISTRATIVE TË MINISTRIVE

Neni 3 Numri i anëtarëve të Qeverisë

1. Qeveria e Republikës së Kosovës ka njëzet e një (21) anëtarë, si vijon:

1.1. Kryeministri;

- 1.2. Zëvendëskryeministri i parë dhe Ministër i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- 1.3. Zëvendëskryeministri i dytë dhe Ministër i Ministrisë së Drejtësisë;
- 1.4. Zëvendëskryeministri i tretë për Çështje të Pakicave dhe Bashkëpunim;
- 1.5. Ministri i Ministrisë së Financave;
- 1.6. Ministri i Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare;
- 1.7. Ministri i Ministrisë së Mbrojtjes;
- 1.8. Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- 1.9. Ministri i Ministrisë së Digjitalizimit dhe Administratës Publike;
- 1.10. Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë;
- 1.11. Ministri i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;
- 1.12. Ministri i Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit;
- 1.13. Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- 1.14. Ministri i Ministrisë së Sportit dhe Rinisë;
- 1.15. Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- 1.16. Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- 1.17. Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit;
- 1.18. Ministri i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit;
- 1.19. Ministri i Ministrisë së Ekonomisë;
- 1.20. Ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim;
- 1.21. Ministri i Ministrisë për Zhvillim Rajonal.

Neni 4 **Përgjegjësitë e Zyrës së Kryeministrit**

Përgjegjësitë e Zyrës së Kryeministrit janë të përcaktuara me Ligjin përkatës për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 5

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD)

1. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka përgjegjësitë si në vijim:

- 1.1. Propozon dhe siguron që procesi i lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare, të bëhet në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;
- 1.2. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e politikës së jashtme dhe diasporës, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- 1.3. Siguron zbatimin e legjislacionit dhe politikave qeveritare nga fushëveprimi i ministrisë;
- 1.4. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;
- 1.5. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;
- 1.6. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 6

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Drejtësisë (MD)

1. Ministria e Drejtësisë ka përgjegjësitë si në vijim:

- 1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e drejtësisë në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- 1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;
- 1.3. Zbaton politikat publike dhe legjislacionin në fushën e drejtësisë;
- 1.4. Ushtron mbikëqyrje ekzekutive mbi shërbimin korrektues dhe shërbimin sprovues në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- 1.5. Zhvillon dhe zbaton politika për të siguruar qasje të drejtë dhe efektive në sistemin e drejtësisë për të gjithë qytetarët pa dallim, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- 1.6. Në kuadër të kompetencave të saj dhe në bashkëpunim me Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur, kontribuon në mbledhjen, sigurimin dhe verifikimin e informacioneve lidhur me fatin dhe vendndodhjen e personave të zhdukur, ofron mbështetje profesionale dhe

institucionale, si dhe shfrytëzon ekspertizën e profesionistëve përkatës dhe të specialistëve të tjerë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

1.7. Përmes Institutit për Mjekës Ligjore, ofron ekspertiza dhe ekzaminime mjeko - ligjore në pajtim me legjislacionin në fuqi;

1.8. Përmes Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar administron me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bashkëpunim me prokurorinë, gjykatën, apo organet tjera kompetente, në pajtim me legjislacionin në fuqi;

1.9. Në fushën e Drejtësisë Tranzicionale, harton dhe zbaton politika dhe strategji, ofron rekomandime ligjore, përmes së cilave, garantohej një qasje e strukturuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;

1.10. Licencon dhe mirëmban regjistrin e noterëve, përmbauesve privat, ndërmjetësuesve, administratorëve falimentues dhe ekspertëve gjyqësor;

1.11. Organizon provimin dhe mbanë evidencë për personat që kanë kaluar provimin për jurisprudencë, noteri, përmbaues privat dhe administratorë falimentues, si dhe zhvillon procesin e rekrutimit për ekspertët gjyqësor;

1.12. Ushtron mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së profesioneve të lira si në vijim: jurisprudenca, noteria, përmbarimi privat, ndërmjetësimi, administratorët falimentues, ekspertët gjyqësor;

1.13. Ofron ndihmë për viktimat e krimit, veçanërisht për viktimat e dhunës familjare dhe trafikimit të qenieve njerëzore;

1.14. Ofron ndihmë juridike ndërkombëtare në pajtim me legjislacionin në fuqi;

1.15. Ofron ndihmë juridike falas në pajtim me legjislacionin në fuqi;

1.16. Përfaqëson institucionet përkatëse në procedurat gjyqësore dhe të arbitrazhit vendor dhe ndërkombëtar, në pajtim me legjislacionin në fuqi;

1.17. Bashkërendon procesin e lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile dhe penale;

1.18. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.19. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë.

1.20. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 7

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Financave (MF)

1. Ministria e Financave ka përgjegjësi si në vijim:

1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e menaxhimit të financave publike, kontrollit të brendshëm dhe auditimit për sektorin publik, standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar për sektorin privat dhe ndërmarrjet publike, borxhit publik, prokurimin publik, politikave makro-ekonomike dhe fiskale, tatimit në pronë, ndihmës shtetërore, duke i respektuar standardet e rëndësishme ndërkombëtare, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;

1.3. Zbaton politikat publike dhe legjislacionin në fushën e menaxhimit të financave publike, kontrollit të brendshëm dhe auditimit për sektorin publik, standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar për sektorin privat dhe ndërmarrjet publike, borxhit publik, prokurimin publik, politikave makro-ekonomike dhe fiskale, tatimit në pronë, ndihmës shtetërore;

1.4. Bashkërendon dhe zbaton menaxhimin e financave publike sipas përgjegjësi ligjore;

1.5. Siguron ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe makrofiskal të Republikës së Kosovës;

1.6. Vlerëson politikat e qëndrueshme fiskale si dhe bën mbikëqyrjen makroekonomike, për zhvillimin e sektorit privat në Republikën e Kosovës;

1.7. Mbikëqyrë zbatimin e rregullave për shpenzimin e parasë publike si dhe kontrollit të brendshëm për organizatat buxhetore, në zbatimin e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e financave publike;

1.8. Menaxhon procesin e planifikimit buxhetor për përgatitjen e Ligjit Vjetor për Ndarjet Buxhetore, Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve si dhe të Programit të Borxhit Shtetëror dhe Garancive Shtetërore;

1.9. Siguron ekzekutimin e ndarjeve buxhetore sipas Ligjit Vjetor për Ndarjet Buxhetore dhe legjislacionit në fuqi;

1.10. Siguron funksionimin e sistemit të tatimit në pronë në Republikën e Kosovës;

1.11. Regjistron dhe raporton për të gjitha të hyrat dhe të dalat nga Buxheti i Republikës së Kosovës;

1.12. Negocion huamarrjen publike, menaxhon shërbimin e borxhit publik dhe pranon grante nga donatorët, sipas legjislacionit në fuqi;

1.13. Përfaqëson Republikën e Kosovës në institucionet ndërkombëtare financiare dhe bashkërendon aktivitetet me këto organizata;

1.14. Siguron zbatimin e legjislacionit tatimor dhe doganor në Republikën e Kosovës;

1.15. Siguron zbatimin e legjislacionin të sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike (menaxhimi financiar i kontrollit dhe auditimi i brendshëm) për të gjitha subjektet e sektorit publik;

1.16. Siguron zbatimin e legjislacionit për partneritet publiko - privat në Republikën e Kosovës;

1.17. Bashkërendon aktivitetet me institucionet e tjera përkatëse dhe siguron zbatimin e legjislacionit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit;

1.18. Bashkërendon zbatimin e procesit të kontrollit të ndihmës shtetërore;

1.19. Siguron realizimin e procedurave të prokurimit të centralizuar për nevojat e organizatave buxhetore;

1.20. Siguron përlogaritjen buxhetore dhe ekzekutimin e pagave, skemave sociale dhe pensionale, sipas legjislacionit në fuqi;

1.21. Bashkërendon procesin e lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e menaxhimit të financave publike, tatimeve dhe doganave;

1.22. Ndiemon organet e vetëqeverisjes lokale në zhvillimin e buxheteve dhe të sistemeve të tyre të menaxhimit të financave;

1.23. Bashkërendon me ministritë përkatëse për t'u siguruar që administratat komunale marrin mjetet buxhetore që ju duhen për t'i ushtruar përgjegjësitë e veta, duke përfshirë investimet publike, për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm komunal;

1.24. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.25. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;

1.26. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 8

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (MPFVLÇ)

1. Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e punës, familjes, vlerave të luftës çlirimtare,

sigurisë dhe mbrojtjes në punë, marrëdhënies së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, dialogut social, punësimit, aftësimit profesional, politikave sociale, transfereve dhe pensioneve, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

1.2. Inicion, lidh dhe zbaton marrëveshje ndërkombëtare, si dhe kryen veprimet e nevojshme në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare;

1.3. Mbikëqyr zbatimin e legjislacionit nga marrëdhënia e punës, sigurisë dhe mbrojtjes në punë, marrëdhënies së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, dialogut social, punësimit, aftësimit profesional, politikave sociale, transfereve dhe pensioneve duke përfshirë beneficinet e veçanta për kategoritë e dala nga lufta, shërbimet sociale dhe familjare dhe dispozitat e tjera të legjislacionit në fuqi;

1.4. Harton dhe koordinon politikat aktive të tregut të punës për nxitjen e punësimit, uljen e papunësisë, si dhe monitoron trendet dhe dinamikat në fushën e punësimit;

1.5. Zhvillon, zbaton dhe mbikëqyr programet e masave aktive të tregut të punës, përfshirë programet e punësimit për të rinjtë dhe skemat e subvencionimit të punësimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi;

1.6. Monitoron dhe analizon dinamikat e kërkesës dhe ofertës në tregun e punës, duke koordinuar politika dhe masa ndërsektoriale për rritjen e përputhshmërisë së aftësive me nevojat e tregut të punës;

1.7. Siguron dhe mbikëqyr programet e aftësimit profesional për të papunët dhe punëkërkuesit, me qëllim zhvillimin e shkathtësive dhe integrimin e tyre në tregun e punës;

1.8. Udhëheq dhe mbikëqyr institucionin publik të punësimit;

1.9. Vendos standarde dhe ushtron autoritetin rregullator për licencimin dhe monitorimin e ofruesve jopublikë të shërbimeve të punësimit, me qëllim forcimin e integritetit të tregut të punës;

1.10. Nxit dhe inkurajon dialogun social në mes partnerëve social, organizatave të punëmarrësve, organizatave të punëdhënësve dhe Qeverisë;

1.11. Licencon dhe ushtron mbikëqyrje dhe kontroll për personat fizik dhe juridik nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë;

1.12. Konvokon takimin e Këshillit Ekonomiko Social, si organ më i lartë këshillëdhënës i Partnerëve Social për politika të punës, politikave sociale dhe politikave tjera ekonomike duke synuar parandalimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sociale dhe përfaqëson Qeverinë e Kosovës në këtë organ;

1.13. Regjistron dhe ushtron mbikëqyrjen dhe kontrollin e ndërmarrjeve sociale si dhe siguron fonde për zhvillimin dhe promovimin e ndërmarrjeve sociale;

1.14. Siguron zbatimin e skemave sociale për mbështetje të familjeve dhe personave në nevojë sociale;

1.15. Udhëheq zhvillimin e sistemit të sigurimit social në nivel vendi, duke përfshirë sistemin pensional të shtyllës së parë;

1.16. Menaxhon skemat pensionale dhe sociale të financuara nga shteti dhe është përgjegjëse për përlogaritjen e skemave pensionale dhe sociale sipas legjislacionit në fuqi;

1.17. Siguron zbatimin e pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe civile dhe veteranëve të luftës;

1.18. Zhvillon dhe zbaton politika dhe akte normative për mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të Luftës Çlirimtare, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

1.19. Zhvillon dhe zbaton politikat për shërbime sociale dhe familjare si dhe mbrojtje për fëmijët;

1.20. Zhvillon dhe koordinon politikat kombëtare në mbështetje të familjes, prindërimit dhe harmonizimit punë - familje, në bashkërendim me ministrinë e tjera dhe nivelin lokal;

1.21. Zhvillon dhe zbaton politika për banim social dhe banim të përballueshëm për familjet dhe kategoritë në nevojë, përfshirë përcaktimin e kriterëve sociale, përzgjedhjen e përfituesve, administrimin e skemave të strehimit social dhe subvencionimin e kostove të banimit, në koordinim me institucionet përgjegjëse;

1.22. Zhvillon programe për ngritjen e burimeve njerëzore të këshillimit për profesionistët e shërbimeve sociale;

1.23. Inspekton dhe monitoron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga institucionet e sektorit publik, organizatat joqeveritare dhe ofruesit privat të licencuar;

1.24. Harton dhe është përgjegjëse për përgatitjen e standardeve minimale dhe Kodit Etik për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare;

1.25. Licencon ofruesit individual dhe joqeveritar të shërbimeve sociale dhe është përgjegjëse për krijimin e institucioneve të kujdesit social dhe rezidencial për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare;

1.26. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.27. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;

1.28. Menaxhon me Çështjet e Trashëgimisë së Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK).

1.29. Kryen edhe detyra të tjera që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 9

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Mbrojtjes (MM)

1. Ministria e Mbrojtjes ka përgjegjësitë si në vijim:

- 1.1. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- 1.2. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e mbrojtjes;
- 1.3. Siguron zbatimin e legjislacionit dhe politikave qeveritare nga fushëveprimi i ministrisë;
- 1.4. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;
- 1.5. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;
- 1.6. Kryen edhe detyra të tjera që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 10

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB)

1. Ministria e Punëve të Brendshme ka përgjegjësitë si në vijim:

- 1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e rendit dhe sigurisë publike, kufijve shtetëror, emergjencave, armëve dhe eksplozivëve për përdorim civil, pajisjen me armë, municion dhe pajisje përkatëse për siguri për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri, sigurisë së aviacionit civil, infrastrukturës kritike, shërbimeve të sigurisë private, sigurisë në bashkësi, parandalimit dhe riintegritimit të personave të radikalizuar, gjendjes civile, inspektimit të regjistrimit civil, migracionit, azilit, riintegritimit të personave të riatdhesuar dhe integritimit të të huajve ripranimit dhe shtetësisë, mbrojtjes dhe akomodimit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, forenzikës, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- 1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;
- 1.3. Zbaton politikat publike dhe legjislacionin në fushën e rendit dhe sigurisë publike, kufijve shtetëror, emergjencave, armëve dhe eksplozivëve për përdorim civil, pajisjen me armë, municion dhe pajisje përkatëse për siguri për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri, sigurisë së aviacionit civil, infrastrukturës kritike, shërbimeve të sigurisë private, sigurisë në

bashkësi, parandalimit dhe riintegritit të personave të radikalizuar, gjendjes civile, inspektimit të regjistrimit civil, migracionit, azilit, riintegritit të personave të riatdhesuar dhe integritit të të huajve, ripranimit dhe shtetësisë, mbrojtjes dhe akomodimit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, forenzikës;

1.4. Koordinon aktivitetet brenda Qeverisë së Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me rendin dhe sigurinë publike;

1.5. Mbikëqyrë Policinë e Republikës së Kosovës, Inspektoratin Policor të Kosovës, Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe Akademinë e Kosovës për Siguri Publike;

1.6. Kontrollon dhe mbikëqyr kufirin shtetëror;

1.7. Bashkëpunon me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e sigurisë dhe rendit publik;

1.8. Koordinon të gjitha aktivitetet në drejtim të mbledhjes, përpunimit, mirëmbajtjes dhe analizës së të dhënave statistikore dhe informacioneve në fushën e sigurisë e të rendit publik;

1.9. Siguron mbrojtjen dhe akomodon viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore;

1.10. Menaxhon shërbimet e inxhinierisë për objektet me rëndësi të veçantë të MPB-së dhe Agjencive të saj;

1.11. Koordinon punën e institucioneve tjera për fushën e përgjegjësisë së MPB-së;

1.12. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.13. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;

1.14. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 11

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Digjitalizimit dhe Administratës Publike (MDAP)

1. Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e digjitalizimit dhe e-qeverisjes, sigurisë kibernetike, sektorit postar, komunikimeve elektronike, teknologjisë së informacionit, ekonomisë digjitale, zyrtarëve publikë dhe të pagave në sektorin publik, organizatave jo

qeveritare, shërbimeve publike administrative, zvogëlimit të barrës administrative, organizimit funksional të institucioneve të administratës shtetërore, duke siguruar përafrimin me *Acquis* të BE-së dhe konventat ndërkombëtare përkatëse, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;

1.3. Përgatitjen e politikave publike në fushën e akomodimit të institucioneve të nivelit qendror të Republikës së Kosovës;

1.4. Zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e politikave publike dhe legjislacionit në fushën e digjitalizimit dhe e-qeverisjes, sigurisë kibernetike, sektorit postar, komunikimeve elektronike, teknologjisë së informacionit, ekonomisë digjitale, zyrtarëve publikë dhe të pagave në sektorin publik, organizatave jo qeveritare, shërbimeve publike administrative, zvogëlimit të barrës administrative, organizimit funksional të institucioneve të administratës shtetërore;

1.5. Zhvillon, promovon dhe bashkërendon zbatimin e politikave për aftësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të shërbimit civil dhe të administratës publike në Kosovë;

1.6. Menaxhon dhe bashkërendon punën rreth procesit të reformës së administratës publike;

1.7. Zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e politikave dhe legjislacionit për shërbimet publike administrative, zvogëlimit të barrës administrative dhe organizimit funksional të institucioneve të administratës shtetërore;

1.8. Zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e politikave dhe legjislacionit për pagat në sektorin publik;

1.9. Përcakton standarde të detyrueshme dhe ofron shërbime menaxhuese të inxhinierisë dhe të ndërtimit për institucionet qendrore të Republikës së Kosovës;

1.10. Vendos standardet për shërbimet e teknologjisë së infomacionit dhe komunikimit, digjitalizim të shërbimeve dhe e-Qeverisjen për institucionet e Kosovës.

1.11. Zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e politikave, legjislacionit dhe standardeve për teknologji të informacionit dhe digjitalizim të shërbimeve;

1.12. Zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e politikave, legjislacionit dhe standardeve për siguri kibernetike;

1.13. Zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e politikave, legjislacionit dhe standardeve për siguri kibernetike;

1.14. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.15. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;

1.16. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 12

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Shëndetësisë (MSH)

1. Ministria e Shëndetësisë ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e shëndetësisë duke i respektuar standardet e rëndësishme ndërkombëtare, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;

1.3. Zbaton legjislacionin për kujdesin shëndetësor bazuar në parimet e një sistemi jo diskriminues dhe të përgjegjshëm;

1.4. Koordinon aktivitetet në fushën e shëndetësisë për nxitjen e zhvillimit koherent të politikës për shëndetësi;

1.5. Mbikëqyrë zbatimin e standardeve në fushën e shëndetësisë, duke përfshirë edhe inspektimin dhe shërbime të tjera sipas nevojës;

1.6. Ndjek situatën e shëndetësisë dhe zbaton masat adekuate për të parandaluar dhe kontrolluar problemet në lëmin e shëndetësisë;

1.7. Menaxhon shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës, që ndërlidhet me kujdesin shëndetësor nën përgjegjësinë e kësaj ministrie;

1.8. Përkrah pjesëmarrjen, iniciativat dhe zhvillimin e aktiviteteve të komunitetit, që ndërlidhen me shëndetin;

1.9. Merr pjesë në zhvillimin dhe zbatimin e fushatës për informim publik dhe të projekteve të tjera promovuese për të rritur vetëdijesimin publik dhe pajtueshmërinë me standardet shëndetësore;

1.10. Inkurajon zhvillimin e arsimit shëndetësor për ngritjen e njohurive dhe kompetencave në lëmin e shëndetësisë;

1.11. Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural mbikëqyrë shërbimet e kontrollit të cilësisë së ushqimit dhe të lëndëve të para bujqësore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve;

1.12. Menaxhon dhe mbikëqyr punën e institucioneve të kujdesit rezidencial në nivel qendror për personat me aftësi të kufizuara;

1.13. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.14. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;

1.15. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen Ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 13

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH)

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e zhvillimit të edukimit në fëmijërinë e hershme, arsimin para universitar, arsimin e lartë, në shkencë dhe inovacion shkencor në Republikën e Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;

1.3. Zbaton politikat publike dhe legjislacionin në fushën e zhvillimit të edukimit në fëmijërinë e hershme, arsimin para universitar, arsimin e lartë, në shkencë dhe inovacion shkencor në Republikën e Kosovës;

1.4. Përkrah një sistem arsimor jo diskriminues, ku respektohet e drejta e çdo personi për shkollim dhe ku mundësitë për mësim cilësor janë në dispozicion të të gjithëve;

1.5. Ofron arsim joformal dhe arsim për të rritur në të gjitha nivelet dhe përkrah mundësitë e shkollimit gjatë gjithë jetës;

1.6. Përpilon, zbaton dhe mbikëqyrë format e drejta dhe efektive të administratës edukativo-arsimore, aftësuese dhe të menaxhimit të shkollave, institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve shkencore dhe të inovacionit shkencor;

1.7. Përmirëson cilësinë e edukimit, arsimit, aftësimit, studimit, hulumtimit, të arriturave shkencore dhe inovacionit shkencor dhe rrit efikasitetin në të gjitha këto fusha;

1.8. Ndihmon zhvillimin dhe përmirësimin cilësor të sistemit arsimor dhe shpërndarjen e shërbimeve arsimore;

1.9. Bashkëpunon me entitetet vendore dhe ndërkombëtare në përkrahje të hulumtimit lidhur me zhvillimin social, ekonomik, shkencor inovativ dhe kulturor të Republikës së Kosovës;

1.10. Ndërton një sistem gjithëpërfshirës bibliotekar në institucionet edukativo-arsimore, në përputhje me standardet kombëtare dhe nevojat e procesit mësimor, kërkimor dhe shkencor.

1.11. Përkrah një politikë gjithëpërfshirëse për integrimin e personave me aftësi të kufizuara në sistemin edukativo-arsimor dhe aftësues;

1.12. Përkrah pjesëmarrjen e prindërve dhe të komunave në aktivitetet arsimore dhe në format përkatëse të bashkëpjesëmarrjes shkollë-komunitet në nivelin lokal;

1.13. Planifikon, zhvillon, mbështet dhe mbikëqyr infrastrukturën fizike dhe teknologjike të institucioneve edukativo-arsimore, të arsimit të lartë, institucioneve shkencore dhe të inovacionit shkencor, duke siguruar përputhshmëri me standardet e sigurisë, qasjes dhe qëndrueshmërisë, si dhe mbështet zhvillimin e infrastrukturës për edukimin në fëmijërinë e hershme dhe arsimin parauniversitar;

1.14. Ushtron funksionin e mbikëqyrjes, inspektimit dhe monitorimit të zbatimit të legjislacionit, standardeve dhe politikave në fushën e edukimit në fëmijërinë e hershme, arsimit parauniversitar, arsimit të lartë, arsimit joformal dhe arsimit për të rritur, si dhe në fushën e shkencës dhe inovacionit shkencor, përmes mekanizmave institucionalë të përcaktuar me ligj;

1.15. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.16. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;

1.17. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 14

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit (MKT)

1. Ministria e Kulturës dhe Turizmit ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e kulturës, të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta si dhe fushën e Turizmit, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;

1.3. Propozon, harton dhe monitoron zbatimin e legjislacionit për fushën e turizmit duke siguruar turizëm të qëndrueshëm dhe konkurrues në Republikën e Kosovës;

1.4. Zbaton planet e veprimit dhe legjislacionin për të përkrahur fushën e kulturës, duke përfshirë programet e institucioneve të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, avancimin e lidhjeve kulturore dhe shkëmbimeve ndërkulturore të artistëve, shoqatave kulturore dhe institucioneve të kulturës;

1.5. Zbaton planet e veprimit dhe legjislacionin për të përkrahur fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, duke përfshirë programet për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin

e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, avancimin e legjislacionit përkatës dhe licencimin e Shoqatave për Administrim Kolektiv të të Drejtave;

1.6. Harton programe për ngritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve kulturore dhe ndihmon në vendosjen e kontakteve, shkëmbimin e informatave dhe përvojave më të mira;

1.7. Harton programe për ngritjen e nivelit të komunikimit kulturor dhe bashkëjetesës mes kulturave të të gjitha komuniteteve etnike, fetare apo gjuhësore në vend, duke përfshirë edhe promovimin kulturor dhe bashkëpunimin në fushën e kulturë;

1.8. Organizon dhe ndjek panairë dhe ngjarje të tjera të turizmit për të promovuar Kosovën si destinacion turistik;

1.9. Udhëheq Këshillin e Turizmit sipas legjislacionit në fuqi;

1.10. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.11. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;

1.12. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 15

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Sportit dhe Rinisë (MSR)

1. Ministria e Sportit dhe Rinisë ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e sportit dhe rinisë, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;

1.3. Zbaton planet e veprimit dhe legjislacionin për të përkrahur fushën e rinisë, organizatat rinore, klubet, qendrat rinore dhe organizatat e përfaqësimit, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në vendim marrje dhe në jetën publike, pjesëmarrjen në edukimin jo formal, në punësueshmëri, edukim dhe promovim shëndetësor, si dhe në kulturë, sport dhe rekreacion;

1.4. Zbaton planet e veprimit dhe legjislacionin për të përkrahur funksionimin e aktiviteteve dhe infrastrukturës në sport, duke përfshirë programet për mbështetjen e sportistëve, specialistëve të sportit, klubeve dhe federatave në ngritje të përfshirjes, cilësisë dhe pjesëmarrjes në aktivitete dhe gara sportive në vend dhe ato ndërkombëtare;

- 1.5. Harton programe për ngritjen e cilësisë së shërbimeve, rinore dhe sportive dhe ndihmon në vendosjen e kontakteve, shkëmbimin e informatave dhe përvojave më të mira;
- 1.6. Harton programe për ngritjen e nivelit të komunikimit në sport dhe rini, duke përfshirë edhe promovimin dhe bashkëpunimin në fushën e rinisë dhe sportit jashtë vendit;
- 1.7. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;
- 1.8. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;
- 1.9. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 16

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka përgjegjësitë si në vijim:

- 1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e vetëqeverisjes efikase komunale dhe për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- 1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;
- 1.3. Promovon dhe afirmon të drejtën e organeve lokale për vetëqeverisje lokale në pajtim me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale;
- 1.4. Bashkërendon dhe promovon zhvillimin e reformës së pushtetit lokal;
- 1.5. Bashkërendon dhe përkrah bashkëpunimin ndërkomunal dhe ndërkufitar;
- 1.6. Mbikëqyrë cilësinë e shërbimeve komunale;
- 1.7. Identifikon dhe zhvillon programe për ngritjen e kapaciteteve institucionale të organeve të vetëqeverisjes lokale;
- 1.8. Promovon dhe zhvillon transparencën e organeve të vetëqeverisjes lokale;
- 1.9. Ofron këshilla dhe udhëzime ligjore për komunat;
- 1.10. Bashkërendon aktivitetet e agjencive ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare që kanë të bëjnë me komunat duke përfshirë koordinimin e agjendës evropiane për komuna;

1.11. Vlerëson ligjshmërinë e akteve të organeve komunale në bashkëpunim me ministritë përkatëse;

1.12. Monitoron dhe mbikëqyrë komunitet gjatë zbatimit të përgjegjësisë dhe kompetencave të tyre në bashkërendim me ministritë përkatëse;

1.13. Kontribuon në respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut nga organet e vetëqeverisjes lokale;

1.14. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.15. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë; dhe

1.16. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 17

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ujërave, planifikimit hapësinor, ndërtimit, banimit, kadastrit, duke siguruar përafrimin me Acquis të BE-së dhe konventat ndërkombëtare përkatëse, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;

1.3. Zbatimin e politikave publike dhe legjislacionin në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ujërave, planifikimit hapësinor, ndërtimit, banimit, kadastrit;

1.4. Koordinon aktivitetet në sektorin e mbrojtjes së mjedisit dhe planifikimit hapësinor për nxitjen e zhvillimit koherent të politikës për fushën e përgjegjësisë administrative të saj;

1.5. Mbikëqyrë zbatimin e standardeve të vendosura, duke përfshirë edhe inspektimin dhe shërbimet e tjera, sipas nevojës brenda fushës së përgjegjësisë administrative të saj;

1.6. Menaxhon shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës, që ndërlidhet me mbrojtjen e mjedisit në përgjegjësinë e saj;

1.7. Përkrah pjesëmarrjen, iniciativat dhe zhvillimin e aktiviteteve të komunitetit, që ndërlidhen me fushën e përgjegjësisë administrative të saj;

1.8. Merr pjesë në zhvillimin dhe zbatimin e fushatës për informim publik dhe të projekteve të tjera promovuese për të rritur vetëdijesimin publik dhe pajtueshmërinë me standardet brenda fushës së përgjegjësisë administrative të saj;

1.9. Mbikëqyrë dhe konstaton gjendjen e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, në veçanti ndikimin e veprimtarisë industriale, të shërbimeve publike dhe të veprimtarisë ekonomike, meqë edhe këto ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit;

1.10. Në bashkëpunim me ministritë përkatëse identifikon zonat që duhen mbrojtur për të mirën e popullatës, krijon politikën dhe zbaton masa për ruajtjen dhe administrimin e tyre;

1.11. Ofron ekspertizë, mbikëqyrë dhe vlerëson dokumentet e planifikimit hapësinor komunal;

1.12. Harton dhe siguron inkorporimin e planit hapësinor të Kosovës në politikën dhe në programet e Qeverisë dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre nga autoritetet përkatëse;

1.13. Përgatit propozim-vendimet për hartimin dhe revidimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor si: Planit Hapësinor të Kosovës, Hartës Zonale të Kosovës dhe Planeve Hapësinore për Zonat e Veçanta, së bashku me programin për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit;

1.14. Administron dhe mirëmban bazën e të dhënave për planifikim hapësinor;

1.15. Administron dhe mirëmban sistemin kadastral dhe të standardeve;

1.16. Mbikëqyrë dhe koordinon të gjitha aktivitetet e agjencive ekzekutive në kuadër të saj, në drejtim të hartimit, monitorimit, vlerësimit, dhe implementimit të politikave brenda fushës së përgjegjësisë së saj;

1.17. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.18. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;

1.19. Harton, zbaton dhe mbikëqyrë politikat dhe dokumentet strategjike për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj tyre;

1.20. Udhëheq dhe zbaton politikat për kalimin në ekonominë qarkulluese, duke vendosur dhe monitoruar objektivat për parandalimin, reduktimin, riciklimin dhe ripërdorimin e mbeturinave, si dhe zbatimin e parimit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (EPR);

1.21. Koordinon procesin e identifikimit, shpalljes dhe administrimit të zonave të mbrojtura, duke përgatitur infrastrukturën ligjore dhe hapësinore për krijimin e rrjetit ekologjik evropian ("Natura 2000") në pajtim me direktivat e BE-së;

1.22. Krijon, administron dhe modernizon Sistemin Informativ Mjedisor, duke siguruar monitorimin e vazhdueshëm të treguesve mjedisorë (cilësisë së ajrit, ujërave, tokës) dhe garanton qasjen e pakufizuar të publikut në informata mjedisore;

1.23. Bashkëpunon me ministritë dhe institucionet e tjera përkatëse për hartimin e politikave dhe instrumenteve ekonomike, përfshirë taksat mjedisore, për të stimuluar investimet e gjelbra, përdorimin efikas të burimeve natyrore dhe zbatimin e plotë të parimit "ndotësi paguan".

1.24. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 18

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)

1. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e bujqësisë, bujqësinë organike, blegtorisë, prodhimit dhe mbrojtjes së bimëve, pylltarisë, gjuetisë dhe peshkimit, ujitjes së tokave bujqësore, shfrytëzim të qëndrueshëm të tokës bujqësore, mbrojtjen e tokës nga ndërtimet e pa planifikuara urbane dhe rregullimin e tokës bujqësore, si dhe zhvillimit rural, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;

1.3. Zbaton legjislacionin në fushën e bujqësisë, bujqësisë organike, blegtorisë, prodhimit dhe mbrojtjes së bimëve, ujitjes së tokave bujqësore, shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës bujqësore, mbrojtjen e tokës nga ndërtimet e pa planifikuara urbane dhe rregullimin e tokës bujqësore, zhvillimit rural dhe për të ndihmuar menaxhimin e qëndrueshëm të fushës së pylltarisë, duke përfshirë edhe shfrytëzimin, mbrojtjen e fondit pyjor, florës dhe faunës së egër, ekoturizimit, aktivitetet e ripyllëzimit, luftimin dhe parandalimin e zjarrit, dezinfektimin nga insektet dhe nga sëmundjet dhe dëmtuesit e ndryshëm, licencimin për prerjen e drunjve, menaxhon me pyjet dhe tokat pyjore shtetërore;

1.4. Lehtëson zhvillimin e skemës kreditore dhe koordinon donacionet për mbështetje të bujqësisë, pylltarisë dhe aktiviteteve për zhvillimin rural në sektorin privat;

1.5. Kontrollon dhe mbikëqyrë aktivitetet e gjuetisë dhe të peshkimit;

1.6. Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësi, ministrinë përgjegjëse për mjedis dhe planifikim hapësinor dhe institucionet tjera mbikëqyrë zbatimin e standardeve shëndetësore, që ndërliken me bujqësinë, pylltarinë, blegtorinë dhe zhvillimin rural;

1.7. Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësi, ministrinë përgjegjëse për mjedis dhe planifikim hapësinor dhe institucionet tjera, mbikëqyrë kontrollin e cilësisë së ushqimeve dhe të lëndëve të para bujqësore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve;

1.8. Mbikëqyrë aktivitetet që synojnë zhdukjen e insekteve, parazitëve, sëmundjeve të bimëve apo shkaktarëve të tjerë të shkatërrimit;

1.9. Merr pjesë në aktivitetet e mbrojtjes së ambientit, që kanë të bëjnë me bujqësinë, pylltarinë, gjuetinë, peshkimin dhe menaxhimin e resurseve të ujit;

1.10. Promovon prodhimet – produktet bujqësore, organizimin e prodhuesve, përpunuesve, tregtuesve, mbështetë dhe prezanton të arriturat shoqatave dhe prodhuesve në bujqësi, pylltari dhe blegtori;

1.11. Harton dhe zbaton strategjinë kombëtare dhe politikën për bujqësi dhe zhvillim rural për sektorët dhe nën sektorët e bujqësisë, ushqimit dhe diversifikimit rural duke përfshirë masat e zhvillimit rural, masat për pagesa direkte, masat e organizmit të tregut dhe masat tjera për bujqësi dhe zhvillim rural;

1.12. Harton standardet për prodhimtarinë në fermë dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre;

1.13. Zbaton, monitoron dhe vlerëson Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural përmes procesit të konsultimit dhe dialogut me partnerët social dhe ekonomik, OJQ-të dhe akterët tjerë në procesin e programimit, monitorimit dhe vlerësimit të PZHRB-së;

1.14. Dizajnon dhe propozon politikat bujqësore në aspektin e masave makro – ekonomike (taksat, çmimet, shkëmbimin tregtar, masat stimulative etj.);

1.15. Krijon dhe përditëson një sistem të qëndrueshëm dhe të integruar të të dhënave për bujqësi dhe zhvillim rural (FADN, GIS etj.);

1.16. Organizon dhe jep këshilla profesionale si dhe trajnon fermerët në fushën e bujqësisë, blegtorisë, pylltarisë, prodhimit, përpunimit dhe marketingut;

1.17. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.18. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;

1.19. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 19

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit (MIT)

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e transportit rrugor, hekurudhor, ajror, detar dhe

sigurisë në rrugë duke siguruar përafrimin me Acquis të BE-së dhe konventat ndërkombëtare përkatëse, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;

1.3. Zbatimin e politikave publike dhe legjislacionin në fushën e transportit rrugor, hekurudhor, ajror, detar dhe sigurisë në rrugë;

1.4. Në sektorin e infrastrukturës rrugore zhvillon programe për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve publike, siguron financimin dhe organizon dhënien e koncesioneve sipas nevojës;

1.5. Mbikëqyrë financimin dhe menaxhimin e infrastrukturës rrugore, duke përfshirë edhe kryerjen e punëve teknike, organizative dhe zhvillimore përkitazi me ndërtimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve publike, kontrollon gjendjen e rrugëve, si dhe mirëmban dokumentacionin për rrugët publike dhe trafikun rrugor;

1.6. Cakton standarde dhe kritere teknike të cilave duhen të ju përmbahen në infrastrukturë dhe ofruesit e shërbimeve, mbikëqyr zbatimin e tyre duke garantuar një infrastrukturë cilësore dhe ofrim të shërbimeve në të mirë të qytetarëve;

1.7. Mbikëqyrë dhe përcjell punën e sektorëve dhe prezanton masa adekuate për të tejkaluar vështirësitë dhe problemet e shërbimeve nga fusha e infrastrukturës;

1.8. Në sektorin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, mbikëqyrë procedurat e licencimit të ofruesve të shërbimeve, automjeteve dhe të shoferëve, jep autorizime operative, itinerarin dhe intervalin kohor në bazë të konkurrencës dhe mbështet sigurimin e shërbimeve humanitare dhe të shërbimeve të tjera të veçanta;

1.9. Mbikëqyrë sigurinë e transportit, ndërmarrjen e veprimeve, hetimeve dhe të masave të nevojshme me qëllim zvogëlimin e rrezikut për jetë dhe dëmeve të tjera për fushën e përgjegjësisë administrative të saj;

1.10. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.11. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;

1.12. Zhvillon dhe menaxhon sisteme digjitale për administrimin e infrastrukturës dhe transportit, përfshirë regjistra elektronikë, platforma për licencim online dhe shërbime elektronike për qytetarët dhe operatorët ekonomikë;

1.13. Vendos dhe operon sisteme inteligjente të trafikut dhe monitorimit në kohë reale, duke përdorur të dhëna analitike për planifikim, rritje të sigurisë rrugore dhe optimizim të lëvizjes së udhëtarëve dhe mallrave;

1.14. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 20

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI)

1. Ministria së Industrisë, Ndërmarrësisë Tregtisë dhe Inovacionit ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e tregtisë, industrisë, inovacionit dhe ndërmarrësisë, investimeve të huaja dhe investimeve strategjike, rezervat shtetërore të mallrave, mbrojtjes së konsumatorit, metrologjisë, akreditimit, standardizimit, rregullimin e tregut naftës, kontrollin e tregtisë me mallra strategjike, pronësisë industriale, duke siguruar përafrimin me Acquis të BE-së dhe konventat ndërkombëtare përkatëse, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;

1.3. Zhvillon politikat industriale, analizat e sektorëve industrial si dhe me agjencitë zbatuese harton skemat përkrahëse për zhvillimin e industrisë përpunuese dhe prodhuese si dhe siguron zbatimin dhe monitorimin e tyre;

1.4. Përgatitjen e politikave dhe hartimin e akteve ligjore për përkrahjen e konkurrencës së drejtë;

1.5. Harton dhe zbaton politika dhe legjislacionin në fushën e ndërmarrësisë, ndërmarrjeve mikro të vogla dhe të mesme si dhe monitoron zbatimin dhe implementimin e projekteve të inovacionit dhe ndërmarrësisë, përfshirë inkubatorët TIK të financuara nga Ministria;

1.6. Harton dhe zbaton politikat dhe legjislacionin për të promovuar ndërmarrësit vendor dhe ekosistemin ndërmarrës dhe inovativ;

1.7. Zhvillimi i partneriteteve me qendrat start-up në nivel ndërkombëtar;

1.8. Zbatimi i programeve kombëtare, skemave të granteve si dhe projekteve ndërkombëtare që mbështesin zhvillimin e NVM-ve, bizneseve fillestare dhe ekosistemeve përkatëse;

1.9. Bashkëpunon me institucionet relevante në zhvillimin e politikave të ndërmarrjeve mikro të vogla dhe të mesme si dhe propozon dhe harton programet e trajnimeve që përkrahin avancimin dhe rritjen e konkurueshmërisë së ndërmarrjeve mikro të vogla dhe të mesme;

1.10. Harton dhe zbaton politika dhe programe që mbron, përkrahë dhe stimulon zhvillimin e sektorit privat, përfshirë ndërmarrjet fillestare (start up) dhe inovacionin në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e linjës, agjencitë zbatuese, sektorin privat, akademinë dhe shoqërinë civile;

1.11. Zbaton, bashkërendon dhe mbikëqyrë politikat publike dhe legjislacionin në fushën e tregtisë, industrisë, mbrojtjes së konsumatorit, metrologjisë, akreditimit, standardizimit, naftës,

mallrave strategjike, pronësisë industriale, zonave ekonomike, sektorit privat, inovacionit, ndërmarrësisë, investimeve të huaja dhe investimeve strategjike;

1.12. Koordinon dhe ofron mbështetje në nxitjen e bashkëpunimit në mes të sektorit publik, sektorit privat dhe akademisë për përkrahjen e ideve dhe projekteve inovative me përparësi për të rinjtë dhe gratë;

1.13. Bashkëpunon me komunitetin e biznesit dhe asociacionet e biznesit me qëllim të krijimit të një mjedisi atraktiv biznesor;

1.14. Bashkërendon aktivitetet lidhur me inicimin, negocimin, lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare brenda fushës së përgjegjësisë administrative të saj;

1.15. Administron sistemin e regjistrimit të biznesit;

1.16. Administron me infrastrukturën e cilësisë, duke përfshirë akreditimin e trupave për vlerësimin e konformitetit, aktivitetet metrologjike, si dhe hartimin dhe adaptimin e standardeve në fushën e ekonomisë, të metrologjisë dhe të industrisë;

1.17. Propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve të politikave në fushën e politikave tregtare, duke siguruar përafrimin e tyre me legjislacionin përkatës të BE-së dhe OBT-së;

1.18. Bashkëpunon me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare si dhe Udhëheq Komitetin Nacional për Lehtësimin e Tregtisë, Komitetin Nacional për Tregtinë në Shërbime dhe Udhëheq dhe koordinon dialogun publiko-privat për adresimin dhe zgjidhjen e barrierave tregtare;

1.19. Koordinon dhe monitoron aktivitetet rreth hartimit të legjislacionit për masat mbrojtëse në importe dhe për masa antidumping dhe masat kundërbalancuese, duke siguruar përputhjen me standardet dhe praktikën e BE-së dhe të Organizatës Botërore të Tregtisë;

1.20. Mban dhe administron Rezervat Shtetërore të Mallrave, propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve të politikave lidhur me krijimin, sigurimin, financimin, deponimin, ruajtjen, përdorimin, menaxhimin, përtëritjen, freskimin dhe shpërndarjen e rezervave shtetërore të mallrave në Republikën e Kosovë;

1.21. Propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve të politikave për fushën e tregut të naftës;

1.22. Propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve strategjike/të politikave në fushën e tregtisë me mallra strategjike;

1.23. Propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve strategjike/të politikave për mbrojtjen e konsumatorit dhe të zhvillojë sistemin e trajtimit (online dhe formës elektronike) të ankesave të konsumatorëve;

1.24. Përmes Inspektoratit të Tregut bën mbikëqyrjen administrative të zbatimit të legjislacionit brenda fushës së përgjegjësisë administrative të saj;

1.25. Bashkëpunon me entitetet vendore dhe ndërkombëtare për sektorët e inovacionit dhe ndërmarrësisë dhe përkrah aktivitetet në hulumtim dhe zhvillim lidhur me avancimin social, ekonomik, shkencor dhe teknologjik të Kosovës;

1.26. Propozon politika për rregullimin e tregut të brendshëm, për inovacion dhe ndërmarrësi, si dhe propozon masa lehtësuese për investime të huaja dhe investime strategjike në funksion të zhvillimit të sektorit privat, promovon inovacionin dhe ndërmarrësinë, si dhe ofron përkrahje institucionale në realizim të projekteve me interes strategjik në fushën e zhvillimit të sektorit privat;

1.27. Propozon strukturimin dhe udhëheqë programet (fondet) për inovacion dhe ndërmarrësi, harton politika dhe programe që mbron, përkrahë dhe stimulon zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

1.28. Merr pjesë në Këshillin Kombëtar për Investime, bashkëpunon me pushtetin lokal, komunitetin shkencor, shoqërinë civile, komunitetin e TIK, komunitetin e biznesit dhe me donatorët për themelimin e Qendrave rajonale të inovacionit dhe inkubatorëve të biznesit;

1.29. Udhëheq Këshillin Industrial dhe Këshillin për Inovacion dhe Ndërmarrësi, sipas legjislacionit në fuqi;

1.30. Organizon forume të përbashkëta ekonomike dhe tregtare në zbatim të marrëveshjeve bilaterale dhe ndërkombëtare të nënshkruara për bashkëpunim ekonomik dhe tregtar;

1.31. Organizon ngjarje të rrjetëzimeve të bizneseve vendore dhe ndërkombëtare B2B dhe G2B në të gjithë sektorët industrial, përpunues dhe shërbyes;

1.32. Organizon dhe ndjek panairë tregtare, ngjarjeve dhe misioneve të biznesit për të promovuar Kosovën si destinacion turistik;

1.33. Bën koordinimin ndër-institucional për zhvillimin e inovacionit dhe krijon trupa koordinues në mes të Qeverisë së Kosovës dhe sektorit privat. Mbështet projektet për zhvillimin e resurseve njerëzore në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë, si dhe krijon programe dhe instrumente për të integruar potencialin njerëzor sipas profesioneve me ndikim në zhvillimin e inovacionit dhe ndërmarrësisë;

1.34. Negocion, merr pjesë në negociata dhe zbaton projektet me donatorët, institucionet financiare ndërkombëtare dhe partnerët e tjerë në lidhje me instrumentet financiare në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë në pajtim me ligjin përkatës për marrëveshjet ndërkombëtare;

1.35. Ofron bashkëpunim institucional në drejtim të zhvillimit të parqeve industriale dhe teknologjike në shërbim të zhvillimit të inovacionit dhe ndërmarrësisë;

1.36. Në bashkëpunim me komunitetin e biznesit identifikon, përkrahë dhe ofron trajnime profesionale për ndërmarrësit dhe ndërton një sistem gjithëpërfshirës për mbështetje dhe zhvillim cilësor të ndërmarrësisë;

1.37. Administron dhe mbikqyrë parqet industriale dhe teknologjike në shërbim të zhvillimit të inovacionit dhe ndërmarrësisë;

- 1.38. Ofron informata, koordinon dhe përkrah investimet në Kosovë të pjesëtarëve të diasporës;
- 1.39. Mbikëqyrë dhe koordinon të gjitha aktivitetet e agjencive ekzekutive në kuadër të saj, në drejtim të hartimit, monitorimit, vlerësimit, dhe implementimit të politikave brenda kompetencave të saj;
- 1.40. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;
- 1.41. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;
- 1.42. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 21

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Ekonomisë (ME)

1. Ministria e Ekonomisë ka përgjegjësitë si në vijim:

- 1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e energjisë, minierave duke siguruar përafrimin me *Acquis* të BE-së dhe konventat ndërkombëtare përkatëse, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- 1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;
- 1.3. Zbaton politikat publike dhe legjislacionin në fushën e energjisë, minierave në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- 1.4. Përcakton objektivat caqet dhe masat e politikave kombëtare në fushën e eficiencës së energjisë, si dhe siguron promovimin dhe zbatimin e tyre;
- 1.5. Përcakton objektivat dhe caqet kombëtare për promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.
- 1.6. Ndhmon Qeverinë në ushtrimin e të drejtave të Aksionarit dhe kryeson Komisionin Ministror për Ndërmarrje Publike;
- 1.7. Mbikëqyrë dhe vlerëson Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike sipas legjislacionit;
- 1.8. Mbeshtet procesin e caktimit të caqeve të dekarbonizimit për sektorin e energjisë, hartimit të planeve të veprimit përë arritjen e tyre si dhe bashkëpunon në procesin e monitorimit dhe raportimit për zbatimin e tyre;
- 1.9. Monitoron sistemet e energjisë lidhur me performancën, sigurinë e furnizimit, sigurinë teknike, si dhe trajton e menaxhon me situatat emergjente të cilat lidhen me sigurinë e

furnizimit me energji dhe promovon zbatimin e rregullave dhe standardeve teknike në përputhje me standardet ndërkombëtare;

1.10. Organizon, zhvillon, implementon dhe mbikëqyrë aktivitetet për zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë përmes proceseve të ofertimit konkurrues;

1.11. Përfaqëson Qeverinë e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe rajonale për sektorin e energjisë dhe minierave;

1.12. Përmes Njesisë së Inspektimit të Energjisë bën mbikëqyrjen administrative të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore për energji, pajisje nën presion eficientë të energjisë dhe burime të ripërtëritshme të energjisë;

1.13. Bashkërendon aktivitetet lidhur me negocimin, lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare brenda fushës së përgjegjësisë administrative të saj;

1.14. Promovon/zhvillon bashkëpunimin rajonal në fushën e Energjisë, Minierave dhe përfaqëson sektorët brenda dhe jashtë vendit;

1.15. Propozon listën e rentave minerare për aktivitetet e licencuara për shfrytëzim të resurseve minerale;

1.16. Miraton planet vjetore për Menaxhimin e Resurseve Minerale;

1.17. Identifikon dhe përgatit materialet për propozim të zonave me interes të veçantë mineral;

1.18. Kryen hulumtime gjeologjike dhe në bashkëpunim me autoritetet tjera publike dhe institucionet përkatëse, në mënyrë sistematike bën mbledhjen, arkivimin, kompilimin, përpunimin si dhe i vë në dispozicion të dhënat gjeo-shkencore përkitazi me resurset gjeologjike të Kosovës dhe me kërkesë të Qeverisë i siguron raportet që i ka në dispozicion dhe vlerësimet e ekspertëve lidhur me çështjet gjeo-shkencore;

1.19. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.20. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjisllacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;

1.21. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjisllacionin përkatës në fuqi.

Neni 22

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK)

1. Ministria për Komunitete dhe Kthim ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjisllacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për

miratim në Qeveri, në fushën e promovimit dhe mbrojtjes të të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;

1.3. Promovon dhe zbaton legjislacionin për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer;

1.4. Promovon krijimin e kushteve të përshtatshme për kthim dhe siguron një qasje ndaj kthimit, që bazohet në të drejta;

1.5. Siguron udhëheqjen në krijimin e besimit, në aktivitetet për dialog dhe pajtimin ndërmjet komuniteteve dhe mbështet zbatimin e këtyre aktiviteteve;

1.6. Zhvillon dhe mbikëqyrë zbatimin e një strategjie qeveritare për ndihmë, që iu drejtohet komuniteteve dhe mbështet zhvillimin dhe zbatimin e këtyre strategjive në të gjitha komunat;

1.7. Zhvillon apo menaxhon programe dhe mekanizma për të ndihmuar integrimin në kushte të barabarta të të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, që aktualisht banojnë në Republikën e Kosovës, si dhe për të siguruar kthimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur brenda vendit dhe të refugjatëve;

1.8. Siguron se politika në nivel qendror dhe komunal përfshin dispozita për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe interesave të të kthyerve, duke përfshirë fushën e lirisë së lëvizjes, përdorimin e gjuhëve, lirisë së shprehjes, përfaqësimit të drejtë, arsimit, punësimit dhe qasjes së barabartë në drejtësi, banim dhe shërbime publike e komunale;

1.9. Bën rekomandime dhe bashkërendon aktivitete me ministritë, komunat dhe autoritetet tjera, që kanë të bëjnë me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer;

1.10. Mbështet aktivitetet e komunave për trajtimin e çështjeve të komuniteteve dhe kthimeve, duke siguruar kthimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur brenda vendit dhe të refugjatëve përfshirë punën e komisioneve për ndërmjetësim, komisioneve për komunitete, Komisioni Komunal për Kthim, Komisioni Qendror Shqyrtues, zyrat komunale për komunitete dhe zhvillimin e zbatimin e strategjive komunale për kthim;

1.11. Rishikon dhe iu ofron ndihmë ministrive të tjera në lidhje me procedurat dhe aktivitetet ekzistuese, sikurse edhe politikat e propozuara dhe projektligjet, për të siguruar respektimin e plotë të të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, të personave të zhvendosur brenda vendit dhe të refugjatëve në përputhje me aktet legjislative të institucioneve të Republikës së Kosovës, rregulloreve të komunave me standarde të rëndësishme ndërkombëtare dhe me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

1.12. Koordinon punët (aktivitetet) me ministritë, komunat dhe autoritetet e tjera për gjetjen e zgjidhjes së qëndrueshme për personat e zhvendosur brenda vendit dhe refugjatë dhe nevojat humanitare të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre;

1.13. Koordinon me ministritë përkatëse, komunat dhe institucionet e tjera zbatimin e një strategjie për të drejtat e komuniteteve, në mënyrë që të sigurojë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve, personave të zhvendosur brenda vendit dhe refugjateve, duke iu kushtuar vëmendje të posaçme nevojave të grave, fëmijëve, personave të moshuar dhe grupeve të tjera të ndjeshme;

1.14. Mbikëqyrë dhe mbështet kornizën operative për kthim, për të siguruar një qasje që mbështetet apo bazohet në të drejta dhe që iu përgjigjet nevojave për personat e zhvendosur brenda vendit dhe refugjatë, dhe bashkëpunimit me ministri të tjera, me agjencitë, me mekanizmat ndërkombëtar dhe OJQ-të e ndryshme gjatë këtij procesi;

1.15. Ndhmon në zhvillimin dhe në zbatimin e masave në fushën e informimit publik dhe të projekteve të tjera promovuese për ngritjen e vetëdijes publike përkitazi me të drejtat dhe interesat e komuniteteve e të pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer;

1.16. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.17. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;

1.18. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 23

Fusha e përgjegjësisë administrative e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZHR)

1. Ministria e Zhvillimit Rajonal ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1. Propozon projektligje, propozon dhe nxjerrë akte nënligjore, propozon koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri, në fushën e zhvillimit rajonal dhe zbatimin e tyre, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

1.2. Inicion dhe kryen veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;

1.3. Në bashkëpunim me ministrinë përkatëse për punë të jashtme dhe diasporë dhe me ministritë përkatëse, zhvillon dhe merr pjesë në nismat dhe programet rajonale sa i përket fushës së zhvillimit rajonal;

1.4. Koordinon aktivitetet me institucione të nivelit qendror dhe lokal si dhe akterë tjerë relevant në përkrahje të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar dhe regjenerimit të vendeve të reja të punës;

1.5. Në bashkëpunim me institucionin përgjegjës për integrim evropian dhe ministrinë përkatëse për financa, dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi merr pjesë në administrimin e ndihmës së huaj financiare në fushën e zhvillimit rajonal;

1.6. Zhvillon dhe menaxhon programe për të ofruar zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe bën promovimin e tyre;

1.8. Bashkërendohet me ministrinë përgjegjëse për tregti dhe industri dhe institucionet e tjera për identifikimin e zonave për investime strategjike, zhvillimin e zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;

1.9. Në bashkërendim me ministrinë përgjegjëse për tregti dhe industri dhe ministri tjera të linjes, harton dhe zhvillon kriteret për identifikimin dhe promovimin e brendeve rajonale;

1.10. Përgatit analiza lidhur me zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar;

1.11. Harton raporte vjetore për Qeverinë lidhur me programet dhe iniciativat e zhvillimit rajonal;

1.12. Fusha e përgjegjësisë administrative të kësaj ministrie përfshin zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar në pajtim me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe në asnjë rrethanë nuk nënkupton ndonjë organizim të ri administrativ apo territorial;

1.13. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.14. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;

1.15. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me ligjin përkatës për zhvillimin rajonal të balancuar dhe legjislacionin tjetër përkatës në fuqi.

KAPITULLI III NUMRI DHE PËRBËRJA E STAFIT TË KABINETEVE TË ANËTARËVE TË QEVERISË

Neni 24

Numri i këshilltarëve politikë

1. Kryeministri mund të emërojë deri në pesëmbëdhjetë (15) këshilltarë politikë.
2. Kryeministri, gjithashtu mund të emërojë edhe nga një (1) këshilltar politik për secilin nga komunitetet nga radha e komunitetit serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran, malazez dhe kroat.
3. Zëvendëskryeministri që njëkohësisht ushtron funksion ministror, mund të emërojë deri në dhjetë (10) këshilltarë politikë.

4. Zëvendëskryeministri pa funksion ministror, mund të emërojë deri në tetë (8) këshilltarë politikë
5. Ministri mund të emërojë deri në gjashtë (6) këshilltarë politikë. Postet e këshilltarëve të autorizuar sipas këtij paragrafi mund t'i ndahen edhe zëvendësministrave nga ministri përkatës.
6. Zëvendëskryeministrat, dhe ministrat, gjithashtu mund të emërojnë edhe një (1) këshilltar politik nga komunitetet.

Neni 25

Numri i këshilltarëve të jashtëm politikë

1. Kryeministri mund të emërojë deri në dhjetë (10) këshilltarë të jashtëm politikë.
2. Zëvendëskryeministri mund të emërojë deri në pesë (5) këshilltarë të jashtëm politikë.
3. Ministri mund të emërojë deri në tre (3) këshilltarë të jashtëm politikë.

Neni 26

Stafi i Kabinetit të Kryeministrit

1. Stafi i kabinetit të Kryeministrit përbëhet nga këshilltarët politikë dhe nëpunësit e punësuar në kabinet, të cilët emërohen nga Kryeministri.
2. Stafi i Kabinetit të Kryeministrit është përgjegjës për t'i ofruar ndihmë Kryeministrit lidhur me përkufizimin e vijave të përgjithshme të politikës së Qeverisë dhe për bashkërendimin e punëve të tij.

Neni 27

Stafi i Kabinetit të zëvendëskryeministrit

1. Stafi i kabinetit të zëvendëskryeministrit përbëhet nga këshilltarët politikë dhe nëpunësit e punësuar në kabinet, të cilët emërohen nga zëvendëskryeministri.
2. Stafi i Kabinetit të zëvendëskryeministrit është përgjegjës për t'i ofruar ndihmë zëvendëskryeministrit lidhur me përkufizimin e vijave të përgjithshme të politikës në fushën e përgjegjësisë administrative të zëvendëskryeministrit dhe për bashkërendimin e punëve të tij.

Neni 28

Stafi i Kabinetit të ministrit

1. Stafi i kabinetit të ministrit përbëhet nga këshilltarët politikë dhe nëpunësit e punësuar në kabinet, të cilët emërohen nga ministri.

2. Staf i Kabinetit të ministrit është përgjegjës për t'i ofruar ndihmë ministrit lidhur me përkufizimin e vijave të përgjithshme të politikës së ministrisë dhe për bashkërendimin e punëve të tij.

Neni 29

Roli i Shefit të Stafit të Kryeministrit, zëvendëskryeministrit dhe ministrit

1. Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministri njërin nga këshilltarët e tij e emëron Shef të Stafit.

2. Shefat e Stafit të Kryeministrit, zëvendëskryeministrit dhe ministrit janë përgjegjës për koordinimin e punëve të këshilltarëve politikë të eprorëve të tyre, duke bërë ndarjen e përgjegjësi dhe detyrave, si dhe përcaktojnë procedurat e punës së ekipit të këshilltarëve politikë.

3. Shefi i Stafit të Kryeministrit siguron që të mbahet një regjistër me emrat dhe funksionet e veçanta të të gjithë këshilltarëve politikë në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

4. Pas secilit emërim, eprori përkatës njofton Shefin e Stafit të Kryeministrit me emrat e këshilltarëve politikë dhe me funksionet specifike që u janë dhënë atyre. Njoftimi për emërim të këshilltarëve politikë duhet bërë në afat prej tre (3) ditëve, nga dita e emërimit të tyre.

5. Shefi i Stafit të Kryeministrit koordinon punën me këshilltarët politikë të Kryeministrit, shefat e stafit të zëvendëskryeministrave dhe ministrave, si dhe mban takime të rregullta me ta së paku një herë në muaj.

Neni 30

Roli i shefit të kabinetit të Kryeministrit, zëvendëskryeministrit dhe ministrit

1. Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministri emërojnë njërin nga këshilltarët politikë në cilësinë e Shefit të Kabinetit.

2. Shefat e Kabineteve të Kryeministrit, zëvendëskryeministrit dhe ministrit koordinojnë punën e nëpunësve të punësuar në kabinetet e tyre në nivel administrativ dhe operativ.

Neni 31

Nëpunësit e punësuar në kabinete

1. Nëpunësit e punësuar në kabinete janë kategori e veçantë e zyrtarëve publikë, të cilët ofrojnë mbështetje teknike dhe administrative.

2. Numri i nëpunësve të punësuar në kabinete është si në vijim:

2.1. Kryeministri mund të emërojë deri në pesëmbëdhjetë (15) nëpunës në Kabinet;

2.2. Zëvendëskryeministri mund të emërojë deri në gjashtë (6) nëpunës në Kabinet;

2.3. Ministri mund të emërojë deri në katër (4) nëpunës në Kabinet;

2.4. Zëvendësministri mund të emërojë deri në dy (2) nëpunës në Kabinet;

2.5. Numri i nëpunësve të punësuar në kabinet varet nga planifikimi në ligjin vjetor të buxhetit.

3. Nëpunësit e punësuar në kabinet të Kryeministrit, zëvendëskryeministrave, ministrave dhe zëvendësministrave nuk janë nëpunës civil dhe u pushon mandati me përfundimin e mandatit të eprorit të tyre nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.

Neni 32

Shpenzimet për zëvendëskryeministrin që ushtron funksion ministror dhe stafin e tij

Në rastin kur Zëvendëskryeministri ushtron edhe funksion ministror, shpenzimet për zëvendëskryeministrin dhe stafin e tij mbulohen nga buxheti i ministrisë.

KAPITULLI IV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 33

Dispozita kalimtare

Deri në themelimin e Agjencisë për Integrim Evropian, Zyra e Kryeministrit ushtron edhe kompetencën e udhëheqjes dhe bashkërendimit të procesit të integrimit evropian.

Neni 34

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.

Neni 35

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

20.02.2026